



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR.15/2023¹
PËR FUNKSIONIMIN E NJËSISË SË INTELIGJENCËS

¹ Udhëzim Administrativ MD-Nr. 15/2023, Për funksionimin e njësisë së inteligjencës, i nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë më datë 27.11.2023

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 7 të Ligjit nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës (GZ. Nr. 20, 08.08.2022), duke u bazuar nënin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 Ligjit nr.08/L- 117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr.09/2011.

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD - NR.15/2023 PËR FUNKSIONIMIN E NJËSISË SË INTELIGJENCËS

KAPITULLI I DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është funksionimi i Njesisë së Inteligjencës në Shërbimin Korrektues të Republikës së Kosovës në lidhje me planifikimin, mbledhjen, sistemimin, analizimin, shpërndarjen, arkivimin dhe mbrojtjen e informacionit të inteligjencës specifike që paraqesin kërcënim dhe rrezik për rendin dhe sigurinë e institucioneve korrektuese.

Neni 2 Fushëveprimi

Udhëzimi Administrativ për Funkcionimin e Njesisë së Inteligjencës zbatohet nga Njësia e Inteligjencës së Shërbimit Korrektues të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: SHKK).

Neni 3 Përkufizimet

1. Për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.1. **Njësia e Inteligjencës** - nënkupton Njësinë e Inteligjencës në kuadër të SHKK-së;

1.2. **E drejta për të ditur** - nënkupton se kërkuesi ka kompetencë zyrtare dhe ligjore për informatën e kërkuar;

1.3. **Nevoja për të ditur** - nënkupton se informata e kërkuar është e nevojshme dhe i takon institucioneve kompetente për fillimin, zhvillimin ose kryerjen e një hetimi.

KAPITULLI II FUNKSIONIMI I NJËSISË SË INTELIGJENCËS

Neni 4 Njësia e Inteligjencës

1. Njësia e Inteligjencës është njësi e veçantë në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të SHKK-së me kompetencë për të gjitha Institucionet Korrektuese.
2. Procedura e gradimit për personelin e Njesisë së Inteligjencës zhvillohet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 5 Kompetencat e Njesisë së Inteligjencës

1. Njësia e inteligjencës bënë planifikimin, mbledhjen, sistemimin, analizimin, shpërndarjen dhe mbrojtjen e informacionit që paraqesin kërcënim dhe rrezik për rendin dhe sigurinë e institucioneve korrektuese.
2. Pas vlerësimit të informacionit, Njësia për Inteligjencë njofton Drejtorin e Përgjithshëm të SHKK-së dhe kërkon ndërmarrjen e masave me qëllim të parandalimit të kërcënimit të sigurisë ndaj SHKK-së.
3. Zyrtarët e inteligjencës për të mbledhur informacion gjatë punës së tyre do të përdorin teknikat e specializuara të inteligjencës korrektuese, teknologjitë dhe praktikat më të mira të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
4. Njësia e Inteligjencës është përgjegjëse për identifikimin e individëve dhe grupeve që paraqesin kërcënim të sigurisë në institucionet korrektuese, informimin, shkëmbimin e informacioneve dhe inteligjencës me institucionet kompetente.
5. Njësia e Inteligjencës bashkëpunon me institucionet tjera kompetente me qëllim mbrojtjes së sigurisë së përgjithshme.

Neni 6 Roli i Njesisë së Inteligjencës

Roli i Njesisë së Inteligjencës është që të ofroj informacione dhe të prodhojë produkte të inteligjencës për Drejtorin e Përgjithshëm me qëllim të ruajtjes dhe ngritjes të nivelit të sigurisë në SHKK

Neni 7

Procesi i zhvillimit dhe përpunimit të informacionit

1. Procesi i zhvillimit dhe përpunimit të informacionit në inteligjencë duhet të kalojë në hapat si në vijim:

1.1. planifikimi;

1.2. mbledhja;

1.3. sistemimi;

1.4. analiza;

1.5. vlerësimi;

1.6. shpërndarja;

1.7. rivlerësimi.

2. Hapat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni aplikohen me qëllim të krijimit të produktit të inteligjencës.

3. Përjashtimisht në raste kur informacionet vlerësohen të jenë të natyrës urgjente, mund të mos aplikohen hapat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Mënyra e zbatimit të procesit të inteligjencës do të përcaktohet me rregullat standarde të veprimit.

Neni 8

Burimet dhe informacionet

Njësia inteligjencës me qëllim të ruajtjes së sigurisë në Institucionet Korrektuese i shfrytëzon të gjitha burimet e informacioneve të brendshme dhe të jashtme që ndërlidhen me Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Neni 9

Trajtimi i informacioneve të inteligjencës

Informacionet e inteligjencës në SHKK si dhe informacionet tjera që ndërlidhen me inteligjencë trajtohen në pajtim me legjislacionin në fuqi për klasifikimin e informacioneve.

Neni 10

Ruajtja e konfidencialitetit

1. Njësia e Inteligjencës duhet të mbrojë burimet e informacionit, metodat, mjetet e punës, hetimet dhe të drejtat e njeriut në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Obligimi për të mbrojtur këto informacione nuk pushon edhe kur zyrtari nuk është më pjesë e Njesisë së Inteligjencës apo përfundon marrëdhënien e punës në SHKK-së.

Neni 11
Shpërndarja e inteligjencës

Drejtori i Njesisë së inteligjencës me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, lejon shpërndarjen e produktit të inteligjencës tek institucionet tjera relevante të sigurisë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 12
Bashkëpunimi

1. Njësia e Inteligjencës bashkëpunon me të gjitha njësitë e SHKK-së.
2. Personeli i SHKK-së është i obliguar që Njesisë së Inteligjencës t'i mundësojnë dhe lehtësojnë qasjen në mbledhjen e informacioneve në Institucionin Korrektues.
3. Njësia e Inteligjencës për zbatimin e përgjegjësi të saj bashkëpunon me institucionet tjera kompetente të SHKK-së në fushën e sigurisë.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetë Zyrtare.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

27/11/2023